



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:114374  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05736809

Ac.nr.7365/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale, Halide Reka, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit I... "L..." sh.a, me seli në P..., të cilën e përfaqëson drejtori gjeneral Milazim Morina, me autorizim e përfaqësuar nga D... C.. A... sh.p.k, kundër debitorit H... M... nga fshati K... e P., Komuna e S... dhe F... A... nga S..., për shkak të përmbartimit- sipas dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skënderaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.47/2018, të datës, 13.09.2019, jashtë seance me dt.27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit I... "L..." sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skënderaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.47/2018, të datës, 13.09.2019 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar, PPP.Nr.47/2018, të datës 13.09.2019, e ka hedhë poshtë si të palejuar kërkesën e kreditorit I... L... Sh.a me seli në Prishtinë për kthim në gjendje të mëparshme.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë kreditori I... L... sh.a, me seli në P..., për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovojë si të bazuar dhe aktvendimi i atakuar PPP.nr.47/2018, i datës 13.09.2019, të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Debitorët nuk kanë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtares individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)

e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbareim në bazë të Marrëveshjes së Pengut për kolateralin e luajtshëm Nr.719/2011 BB, të lidhur në mes të I... L... Sh.a dhe H... M.... (Kredimarrës) dhe F... A... (Garantues). Propozimi është lejuar nga Përmbareuesi Privat Bardh B. Tasholli me Urdhrin Përmbareimor P.nr. 24/18 të datës 05.06.2018.

Me aktin përcjellës të dt. 13.07.2018 përmbareuesi privat i ka përcjellur shkresat e lëndës Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, për të vepruar sipas kundërshtimit të ka ushtruar nga debitori H...M... me dt.22.06.2018 dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit të dt. 28.06.2018.

Gjykata e shkallës së parë me Konkulzionin e dt. 22.11.2018 i ka kthyer propozimin për përmbareim kreditorit për plotësim gjegjësisht për sigurimin e autorizimit të kompanisë për përfaqësim D... C... A.. sh.p.k duke i caktuar afatin prej 3 ditësh.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin PPP.nr.47/2018 të datës 11.12.2018 e ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbareim P.Nr.24/2018 të datës 05.06.2018 të kreditorit I... L.. Sh.a, me seli në P... për shkak të mos plotësimit të propozimit për përmbareim sipas konkluzionit PPP.Nr.47/2018 të datës 22.11.2018 e në kuptim të dispozitës së nenit 17 të Ligjit Nr.04/L139 për Procedurën Përmbaremore, lidhur me dispozitën e nenit 99 dhe 102 par.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Kreditori me dt. 17.12. 2018 ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme, të cilën gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar PPP.Nr.47/2018, të datës 13.09.2019, e ka hedhë poshtë si të palejuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar pasi ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se kërkesa është e palejuar pasi që sipas dispozitës së nenit 68 par.2 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore parashihet se: *“Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbareueshëm për përmbareimin me dhunë.”* Ka shtuar se në procedurën përmbaremore si në rastin konkret si dhe në kontekstin e rrethanave të çështjes Aktvendimi PPP.nr.47/2018 i datës 11.12.2018 ndaj të cilit është paraqitur kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme nuk kemi të bëjmë me mos ruajtje të afatit për paraqitjen e ankesës pasi që i njehti nuk është vendim meritore dhe I përmbareueshëm për përmbareim me dhunë, për të cilin shkak të arsyeshëm ligjor të kërkesës në fjalë gjykata e shkallës së parë do të mund të pranonte kthimin në gjendje të mëparshme.

Pretendimet e kreditorit për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përmbaremore gjykata e shkallës së parë në bazë të provave dhe shkresave të lëndës, drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, pasi që kreditori kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të vetme për të argumentuar të kundërtën.

Pretendimet e kreditorit se plotësimi i propozimit është bërë me kohë, brenda afatit të paraparë sipas konkluzionit të datës 22.11.2018 dhe atë është dorëzuar me datë 29.11.2018, Gjykata e Apelit nuk i

aprovoi për shkak se pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës gjeti se përmes ankesës (kërkesë për pthim në gjendje të mëparshme) është dorëzuar një dëshmi e postës, me të cilën D... C... A... ka dorëzuar një dërgesë me datë 29.11.2018, mirëpo nga kjo dëshmi nuk vërtetohet marrësi- kujt i është dorëzuar kjo dërgesë, nuk ka të cekur çfarë lloj shkrese përmban dhe as numër të lëndës, në mënyrë që të verifikohet se plotësimi i propozimit është dorëzuar në postë me të njëjtën dërgesë që paraqitet si dëshmi nga kreditori.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e për të cilat shkaqe ankimore Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.7365/2022, datë 27.05.2024

Gjyqtarja  
Halide Reka